

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE
DREJTORIA E ADMINISTRATËS - DIREKTORIA ZA ADMINISTRATIVEN

№faq/№str. 108
Datë/Date: 02.08.2024



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË –KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË ,KOSOVO POLJE



Ekstrakti nga procesverbali, mbledhja e gjashtë - VI të Kuvendit të Komunës, e mbajtur me datën 27.06.2024, ora 10:00h, në Sallën e Kuvendit të Komunës.

Prezentë në mbledhje ishin anëtarët e Kuvendit të Komunës: Ali Ismaili - Kryesues i Kuvendit të Komunës, Bashkim Krasniqi - Zëvendës Kryesues i Kuvendit të Komunës për Komunitete. Mirlinda Krasniqi, Miranda Shabani, Jetmir Berisha, Vjollca Konjusha, Krenar Dumani, Laureat Gojnovci, Jahush Krasniqi, Fisnik Sllamniku, Etnik Berjani, Fidan Berisha, Durim Hajra, Hasime Kostanica, Doruntina Jashari, Habib Mekolli, Shpend Bardiqi, Vlonjat Hasani, Dardane Sogojeva Shala, Migjen Kolshi, Qëndresa Ademi, Artan Asllani, Arbnore Kelmendi, Hasan Ismajli dhe Radoman Doderovic.

Mungojnë: Mirsad Qyqalla dhe Aida Alimi.

Kryetari i Komunës dhe Drejtorët e Drejtorive të Komunës: Amir Bullatovci - Drejtor për Administratë, Fatlum Berisha - Drejtor për Arsim, Bardhyl Kojçiçi - Drejtor për Infrastrukturë, Mimoza Kolshi - Drejtore e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Ali Topalli - Drejtor për Kulturë, Rini dhe Sport, Parayll Zogjani - Drejtor për Planifikim Urban, Ilir Hasani - Drejtor për Gjeodezi Kadastër e Pronë dhe Vjosa Kida Hyseni - Drejtore e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

Të tjera: Shqipe Islami - Zyrtare për Planifikimin e Buxhetit.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës përshëndeti të pranishmit në mbledhje, pas verifikimit të prezencës së anëtarëve të Kuvendit të Komunës, konstatoi se ekziston kuorumi për mbajtjen e mbledhjes dhe prezantoi këtë:

REND DITE

1. Aprovimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit të Komunës e datës 30.04.2024.
2. Pyetje dhe përgjigje parlamentare.
3. Propozim për shqyrtimin e Projekt-Kornizës Afatmesme Buxhetore Komunale për vitet 2025-2027.
4. Të ndryshme.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Përshëndeti të pranishmit në mbledhje. Lexoi pikat e rendit të ditës për shqyrtim në mbledhjen e sotme dhe hapi diskutimin.

Pas sqarimeve Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, e qiti në votim për shqyrtim në mbledhjen e sotme rendin e ditës.

U votua me: katërmbëdhjetë vota 'për', asnjë votë 'kundër' dhe asnjë abstenime, gjithsej katërmbëdhjetë anëtarë pjesëmarrës në votim nga anëtarët e pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se anëtarët e Kuvendit të Komunës me unanimitet të votave të anëtarëve pjesëmarrës në votim, e aprovuan për shqyrtim rendin e ditës për mbledhjen e sotme.

Pika e parë (1) - Aprovimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit të Komunës e datës 30.04.2024

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim dhe aprovim 'Ekstraktin e procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit të Komunës e mbajtur me datën 30.04.2024 dhe e vazhduar me datën 13.05.2024 dhe 16.05.2024', ftoi anëtarët e Kuvendit të Komunës që të japin vërejtjet apo sugjerimet e tyre.

Durim Hajra: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Ne nuk marrim pjesë në aprovimin e ekstraktit të procesverbalit, për deri sa nuk bëhet publikimi i audio - incizimeve të mbledhjeve të Kuvendit të Komunës.

Hasan Ismajli: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Unë kam disa vërejtje për ekstraktin e procesverbalit, kërkoi që këto të përmirësohen para nënshkrimit dhe publikimit të tij, vërjetjet e mia janë në faqën 7, 8 dhe 15, tek diskutimi im, lidhur me çështjen që ndërlidhet me drunjët, ku e kam dhënë sqarimin tim, andaj kërkoi që diskutimi im të përmirësohet në ekstraktin e procesverbalit të datës 30.04.2024.

Pas sqarimeve Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, e qiti në votim për aprovim 'Ekstraktin e procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit të Komunës e mbajtur më datën 30.04.2024 dhe e vazhduar me datën 13.05.2024 dhe 16.05.2024', me përmirësimin e diskutimit të kolegut z. Hasan Ismajli.

U votua me: katërmëdhjetë vota 'për', tetë vota 'kundër' dhe një abstenim, gjithsej njëzet e pesë anëtarë të pranishëm në mbledhje.

Ne bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Kuvendi i Komunës me shumicë të votave e aprovoi 'Ekstraktin e procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit të Komunës e mbajtur më datën 30.04.2024 dhe e vazhduar me datën 13.05.2024 dhe 16.05.2024', me përmirësimin e diskutimit të kolegut z. Hasan Ismajli.

Pika e dytë (2) - Pyetje dhe përgjigje parlamentare.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: E kemi pikën 'Pyetje dhe përgjigje parlamentare', ftoi anëtarët e Kuvendit të Komunës, që të paraqesin pyetjet e tyre për Ekzekutivin e Komunës.

Durim Hajra: Tani nga Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Mjedisit janë mbjellur pemë dekorative, pyetja ime tani është pse ka stagnuar ky proces, pse nuk janë vendosur barrierat dhe pjesa mbrojtëse e këtyre pemëve, pyetja e dytë te vend varrezat pas rreshjeve të fundit janë shkaktuar shumë dëme në rrugën ë dërgon në varrezat e qytetit, andaj ne kërkojmë riparimin e rrugëve, sepse kjo punë nuk po bëhet si duhet. Për ndriçimin publik tani e kemi një operatorë tjetër ekonomik, ai nuk po funksionon në qytetin e Fushë-Kosovë, por edhe në lagjen e Currëve në fshatin Bardh i Vogël, pastaj në rrugën '12 Qershori' në fshatin Graboc i Poshtëm. Për Drejtorin e Drejtorisë së Gjeodezisë Kadastrit dhe Pronës, e kam pyetjen për pronën me numër 00428-3, ky kjo pronë ka qenë më herët pronë komunale dhe ajo tani është shndërruar në pronë private, ju n akeni thënë se për këtë çështje e keni një vendim të gjykatës, unë e kam mirëkuptimin për këtë punë, por nuk mund të presim në pa fundësi për këtë çështje me rëndësi publike. Po ashtu do të

parashtroui edhe disa pyetje që janë ripërsëritje lidhur me ndërtimin e katit shtesë të komunës, ky katë nuk është menaxhuar si duhet, atje punëtorët janë vendosur pa kryerjen e punimeve, për pesë vite nuk rregullohet rruga 'Imer Prizreni', që është këtu afër komunës në largësi ajrore dy qind metra, ky kemi shumë ankesa të qytetarëve. Për Drejtorin e Drejtorisë së Inspektoratit, pse nuk po ndër merrni asnjë veprim në teren, për zhurmën që shkaktohet nga lokalet e ndryshme në qytet, disa locale e bëjnë këtë zhurmë deri në orën 24:00h, nuk është duke u bërë asgjë për uzurpimin e pronave komunale, ne po jetojmë në qytet me hapësira publike, që ju shërbejnë bizneseve dhe jo qytetarëve që paguajnë tatimin në pronë komunës, kjo drejtori komunale nuk sheh as kur hidhet dheu në pronën publike në fshatin Miradi e Poshtme dhe këtë punë janë duke e bërë disa operatorë ekonomik, që janë të njohur për zyrtarët e komunës. Për Drejtorinë e Arsimit, ka shumë telashe në këtë fushë, ne e kemi mbajtur një takim të Komitetit për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport, ku nga menaxhmenti i shkollës janë paraqitur tetëmbëdhjetë kërkesa, atje pas renovimit të shkollës atje, inventari është në gjendje shumë të keqe, atje janë renovuar disa klasë, por prapë atje ka mbingarkesë, mungojnë edhe gjërat e vogla, rrjeti i internetit është shumë i dobët, sepse aty është operatori i njëjtë për shtatë vite, oborret e shkollave 'Mihal Grameno' dhe 'Selman Riza', aty rruga është e pakalueshme, edhe pse në këto shkolla janë investuar mijëra euro, andaj ne kërkojmë nga Drejtoria e Arsimit që të merrë masa konkrete për përmirësimin e gjendjes në shkollat tona. Për Drejtorin e Drejtorisë së Infrastrukturës, e kam pyetjen kur do të fillon të ndërtohet rruga 'Hajrullah Zymi' në Fushë-Kosovë, sepse pas reshjeve ajo rrugë është e shkatërruar dhe automjetet dhe këmbësorët që kalojnë aty kanë shumë vështirësi, rregullimi i rrjetit të kanalizimit për këtë rrugë nuk është paraparë as në 'Projekt-Kornizën Afatmesme Buxhetore Komunale për vitet 2025-2027'.

Hasan Ismajli: Unë e kam një pyetje për Drejtorin e Drejtorisë së Arsimit, i cili nuk do të duhet të ishte sot këtu, por në prokurori duke u intervistuar, meqë e ka shkelur dispozitat ligjore për ndarjen e subvencioneve, duke e shkelur nenet e shumta të 'Rregullores së Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve për subvencionimin e Organizatave Jo Qeveritare', të vitit 2017, po ashtu janë shkelur edhe shumë nene tjera të 'Rregullores komunale për ndarjen e subvencioneve', të vitit 2013', këtu janë shkelur nenet që përcaktojnë zgjedhjen e përfituesve, pra është shkelur neni 6, neni 11, neni 13, neni 15, në neni 7 sqarohet qartë procedura, por kjo lëndë do të shkon në krime ekonomike, nëse unë nuk marrë përgjigje nga kjo drejtori, unë nuk do të pres dhe ne si subjekt politikë, do ta procedojmë ndarjen e subvencioneve nga thirrja e fundit publike në krime ekonomike. Unë edhe njëherë kërkoi nga Nënkrjetari i Komunës dhe Shefi i Grupit Parlamentarë të Lidhjes Demokratike të Kosovës, kur janë subvencionuar studentët serb, me dokumentacion ilegal, që studijojnë në Universitetin e Mitrovicës së Veriut, me dokumenta jo kushtetuese, andaj kërkoi që ju të distancoheni nga këtu veprime të Ekzekutivit të Komunës në periudhën e kaluar për disa vite me radhë. Ende nuk kemi ndonjë veprim për marrjen e listës së pronave komunale, që është obligim ligjorë të publikohen në ueb-faqën e komunës, por kjo punë nuk do të ndodh asnjëherë, kur punëtorët e kësaj Drejtorie të Komunës bëjnë ngasjen e Xhipave. Për Drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike e Mjedisit hapësira te tregu është shndërruar në parking, pyetja ime është sa është pagesa mujore për këto hapësira publike. Për Drejtorin e Drejtorisë së Planifikimit Urban, pyetja është për objektet e 'Eliza C', që janë ndërtuar nga Kompania ndërtimore 'Cima', ku komuna e ka patur një object prej 400 metra katëror, pyetje ime është a kanë pranim Teknik këto objekte banesore. Për Drejtoreshën e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, e

kam një pyetje për kompensimin e fermerëve pas reshjeve të fundit dhe breshërit, që ka dëmtuar kulturat bujqësore, a është bërë një vlerësim fillestarë për dëmet e shkaktuara. Tek Inspektorati disa autolarje që punojnë të shtunën dhe të dielen, sepse kjo autolarje është e ndërtuar në pronën komunale, fjala është për pjesën te objektet e Kompanisë ndërtimore 'Qami', sepse ju kësaj kompanie ju i keni borxh dhe duhet të ofroni shërbime, ju e dini mirë këtë punë, me herët aty kanë qenë shtëpitë për raste sociale, tani aty është vendosur kjo autolarje dhe ju nuk veproni fare.

Migjen Kolshi: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Ndarja e subvencioneve nga Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit, po bëhet duke u zbatuar në kritere jo përmbajtësore, në secilën ndarje nga kjo drejtori në vitet e fundit përkrahet Burim Berisha, që është edhe Nënkryetar i nën degës së Lidhjes Demokratike të Kosovës në fshatin Bardh i Madh, kërkesa ime është ta dijme, se a paraqet kjo ndarje e subvencioneve konflikt të interesit. Për një festival, ku rinia jonë po sheh degjenerim, i cili mbahet në fshatin Harilaç janë ndarë 9,500.00€. Për Drejtorin e Drejtorisë së Arsimit e kam një pyetje, cili është kriteri për të hyrë në listën e pagave, qëndrimi larg jashtë listës së pagave, me muaj apo vite, apo afërsia dhe lidhjet më njerëzit në komunë, ku duhet të jeni mbesa apo tezja e dikujt që ka lidhje në komunë. Për Drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Mjedisit e kam pyetjen për funksionimin e ndriçimit publik, ku 80% e tij është jo funksional, andaj tani kur e keni një operatorë të ri ekonomik ju ftoi të veproni dhe punoni në teren, në fshatin Harilaç ky ndriçim publik në kohën më të madhe ka qenë dhe është jo funksional. Në fund dua ta dijë cilat janë masat disiplinore që janë marrë nga Drejtoria e Arsimit, për drejtorin e shkollës 'Bajram Curri' z. Fidan Hasani, që ka ushtruar dhunë ndaj nxënësit të klasës së nëntë të fshatit Harilaç, ky rast është paraqitur në Policinë e Kosovës, rasti ka qenë publik edhe në media, këtu pyetja ime është cilat veprime janë marrë nga ana e juaj si Drejtori e Arsimit.

Dardane Sogojeva Shala: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Unë tani këtu dua ta paraqes një shqetësim të qytetarit, e kam edhe lejen e tij, fjala është për Naim Dragusha, këtu fjala është për pjesën e rrugës prej trafos deri te Rudarët në fshatin Sllatinë e Vogël, sepse në atë pjesë është zënë prona komunale dhe qarkullimi ka shumë vështirësi, sepse në atë zonë vendosja e mureve të oborreve të qytetarëve, është e vendosur në pronat komunale. Kërkesë e banorëve të fshatit Graboc i Poshtëm, është që të kyqen në rrjetin e furnizimit më ujë të pishëm. Për Drejtorin e Drejtorisë së Arsimit e kam pyetjen, pse është ndaluar transporti i nxënësve në fshatin Graboc i Poshtëm, ky një fëmijë gjashtë vjeçar, tani atje nuk ka mundësi të shkon në shkollë. Për fshatin Pomozotin është një kërkesë për hapjen dhe rregullimin e rrugës deri te pishat e fshatit Sllatinë e Madhe, fjalën e kam për pjesën nga fshati Bardh i Madh deri te kopshti botanik, a parashihet të shtrohet kjo rrugë. Tani në Fushë-Kosovë është duke u ndërtuar Stadiumi i Qytetit, pyetja ime është a do të rregullohen edhe zhveshtoret në këtë projekt të komunës.

Qëndresa Ademi: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Unë e kam një kërkesë që në fshatin Kuzmin, të intervenohet nga komuna, sepse pas reshjeve atmosferike shtrati del nga lumi dhe shkaktohen vërshime, të cilat nga reshjet e fundit kanë depërtuar edhe në shtëpi të banimit.

Doruntina Jashari: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Unë e kam një pyetje për Drejtorin e Drejtorisë së Infrastrukturës, për kohën kur do të fillon asfaltimi i rrugës 'Hajrullah Zymi' në Fushë-Kosovë, sepse më herët na është thënë se punimet në këtë rrugë do të fillon në fund të muajit qershor, tani jemi në fund të muajit qershor dhe atje punimet ende nuk kanë filluar, ndërsa për Drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Mjedisit, tani kur po bëhet mbjellja e pemëve

dekorative, ne kërkojmë që këto pemë dekorative të mbillen edhe në rrugën 'Pajazit Islami' në Fushë-Kosovë.

Vlonjat Hasani: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Tani këtu numri i Drejtorëve të Drejtorateve Komunale, nuk është i mjaftueshëm në mbledhjen e Kuvendit të Komunës, por unë do të përsëris disa nga pyetjet e mia, për të cilat nuk kam marrë përgjigje. Rruga 'Lumi' në fshatin Miradi e Epërme është duke u diskriminuar nga pushteti aktual, aty ka nevojë urgjente për të rregulluar rrjetin e kanalizimit, kësaj rruge mjafton t'i bëhet një inspektim nga Inspektorët e Komunës, po mundoheni të jepni arsytetime të ndryshme, por ju e dini mirë problemin e kësaj rrugë, andaj ju ftoi që në këtë rrugë të ktheni investimet publike, që janë obligim i komunës ndaj qytetarëve, që kryejnë pagesat e tatimit në pronë dhe kërkojnë kthimin e tyre në investime. Disa pengesa janë vendosur në rrugë ndërmjet dy fshatrave: Miradi e Epërme dhe Miradi e Poshtme, nga ana e 'Petrol Kompanisë', pa pëlqimin e komunës, aty në një zonë prej pesë dhjetë metra gjatësi në rrugë janë vendosur pesë pengesa, andaj unë ju ftoi të dilni në teren dhe të mos lejoni që individët e caktuar të jenë më të fortë se shteti. Këtu Inspektorati i Komunës po tregohet i pa fuqishëm ndaj oligarkëve, e njëjta kompani po e sfidon komunën edhe në rrugën '17 Shkurti' në Fushë-Kosovë, ku qëndrojnë taksitë ilegal, unë ju ftoi që rendi dhe ligji të kthehen në vend, po ashtu në rrugën 'Dëshmori' në fshatin Miradi e Epërme, kompanitë e ndryshme me mjetet e tyre të rënda po bartin mbeturina inerte dhe dhe, për këtë punë kemi edhe foto, të cilat mund t'ua dërgojmë, por nga komuna jonë deri tani nuk ka asnjë veprim. Po ashtu kërkojmë që të dilni në teren dhe të intervenoni edhe të Shtëpia e Kulturës, për pastrimin e zonës, por edhe në rrugë tjera ka nevojë për investime, sikur është rruga 'Binarët', rruga e 'UÇK-së', rruga 'Lumi', për Drejtorinë e Shërbimeve Publike dhe Mjedisit e kemi një kërkesë për pastrim në disa zona në fshatin Miradi e Epërme, në disa zona është kryerë puna po nuk është kompletuar. Edhe rruga 'Zahir pajaziti' në qytet është anashkaluar, gjendja në këtë rrugë është katastrofike, e njëjta gjendje është edhe në rrugën 'Idriz Breznica', uji aty qëndron në rrugë, nevojë për intervenim ka edhe në rrugën 'Arbëria' në Fushë-Kosovë.

Shpend Bardiqi: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Tani numri i banorëve është rritur, ka nevojë për veprime të shumta në teren të Drejtorisë së Shërbimeve Publike e Mjedisit dhe Drejtorisë së Inspektoratit, pyetja është se a kemi në Drejtor të Inspektoratit, sepse dikun më shumë se pesë dhjetë rrugë janë të dëmtuara, andaj tani më duhet të tërheq konstatimin tim të mëhershëm, se Drejtori i Drejtorisë së Administratës është in ekzistentë, tani këtë titull për mos punë duhet të mbanë Drejtori i Drejtorisë së Inspektoratit, këtu më herët Ish/Drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Mjedisit, ka thënë se ne nuk japim leje për parkingje, andaj ato zona janë të uzurpuara për qytetarë nga subjektet afariste, andaj ato duhet të lirohen për qytetarët, duhet të shqiptohen dënime për uzurpatorët e pronës publike. Unë më herët kam kërkuar që në Objektivin shëndetësorë, duhet të vendoset një ekran për të treguar stokun e barnave nga lista esenciale, më keni thënë se kjo punë nuk është e definuar me ligj, unë e kam verifikuar këtë punë, është obligim ligjor, të dihet lista e barnave esenciale për pacientët në shëndetësinë primare, që është në kompetencën e komunës. Unë kam kërkuar insulina në ndërrimin e pasditës, është thënë se nuk e kemi çelësin e depos, andaj nuk mund ta hapim atë deri nesër, kjo qasje është e pa pranueshme, sepse nevojat për njerëzit që kanë probleme me tensionin, duhet të kenë barnat në dispozicion, ato janë pjesë e barnave të listës esenciale.

Hasan Ismajli: Unë dua të sqaroi se në diskutimin tim të mëhershëm, fjalën e kam patur për Drejtorin e Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit, e jo për Drejtorin e Drejtorisë së Arsimit, sepse ndarja e subvencioneve që unë i kam cekur në diskutimin tim, janë ndarë duke u mbështetur në thirrjen publike, të bërë nga Drejtoria e Kulturës. Për çështjen e shpenzimeve të varrimit dhe lidhjes së marrëveshjeve dhe aneks - marrëveshjeve me përfaqësuesit e Bashkësive Fetare, për këtë vitë kjo është bërë vetëm nga ana e Kryetarit të Komunës, andaj unë për këtë çështje vetëm kam biseduar edhe me Auditorin e Brendshëm të Komunës, sepse këtu ka shkelje ligjore, kjo punë kësaj radhe është bërë jashtë Kuvendit të Komunës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Pyetjet e parashtruara mbesin në ekstraktin e procesverbalit, këtu janë prezentë vetëm dy drejtor z. Ali Topalli dhe z. Ilir hasani, ndërsa çështja e kompleksit 'Eliza', ka ndodhur më herët andaj z. Parayll Zogjani, nuk mund të na jap sqarime për kohën kur nuk ka patur përgjegjësi në drejtimin e Drejtorisë së Planifikimit Urban, atje është shumë e qartë se është bërë një punë e keqe. Unë ju rikujtoi edhe një herë se punët e Kuvendit të Komunës dhe Ekzekutivit të Komunës janë të ndara, pyetjet tuaj mbesin në procesverbal si shënime, përgjigjet nëse nuk i keni tani, mund t'i kërkonit që t'i merrni edhe me shkrim.

Pika e tretë (3) - Propozim për shqyrtimin e Projekt-Kornizës Afatmesme Buxhetore Komonale për vitet 2025-2027.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim 'Propozimin për shqyrtimin e Projekt-Kornizës Afatmesme Buxhetore Komonale për vitet 2025-2027', ftoi Zyrtaren për Planifikimin e Buxhetit që të na jap sqarime.

Shqipe Islami - Zyrtare për Planifikimin e Buxhetit: Faleminderit Kryesues, përshëndetje për juve Kryesues, përshëndetje asambleist të Kuvendit Komunal dhe juve të pranishmëve në këtë sallë. Pra siç e ceku Kryesues, unë po e prezentoj Kornizën Afatmesme Buxhetore Komonale për vitet 2025-2027, të cilën e keni para jush. Pas pranimin të Qarkores së Parë Buxhetore Nr. 2024/01 nga Ministria e Financave Punës dhe Transfereve, e pranuar në muajin maj, ne kemi hartuar Qarkoren e Brendshme Komonale Nr. 01 për të gjithë Drejtorët e Drejtorive të Komunës, për të bërë planifikimin e Buxhetit Komunal për vitin 2025 dhe vlerësimet e hershme për vitet 2026-2027, sipas nevojave të domosdoshme të drejtorive të tyre përkatëse. Duhet të theksojmë që kufijtë buxhetor mund të pësojnë ndryshime, për shkak të regjistrimit të popullatës, mirëpo për të qenë në afat kohor për aprovim 'Projekt Ligjin Mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025', këta kufij do të shërbejnë si orientues për përgaditjen fillestare. Kufijtë buxhetor janë përcaktuar me numrin e banorëve 34,827. Korniza Afatmesme Buxhetore Komonale për vitet 2025-2027, është krijuar në përputhje me udhëzimet e Qarkorës Buxhetore Nr. 2024/01, ku Buxheti i Komunës së Fushë-Kosovës për vitet 2025-2027 është: për vitin 2025 është në shumën e mjeteve financiare prej: 16,747,838.00€, për vitin 2026 është në shumën e mjeteve financiare prej: 17,592,179.00€ dhe për vitin 2027 është në shumën e mjeteve financiare prej: 18,456,253.00€. Këto vlera i keni të paraqitura në Tabelen Nr. 1 në Kornizën Afatmesme Buxhetore Komonale për vitet 2025-2027. Vlerat janë siguruar nga dy burime kryesore: Grantet Qeveritare dhe të Hyrat Vetjake. Per vitin 2025 nga Qeveria janë ndarë 13,288,163.00€ ose 80% e buxhetit total dhe nga të Hyrat Vetjake në vlerë prej 3,459,675.00€ ose 20%. Pra totalin e Buxhetit të vitit 2025 në vlerë prej: 16,747,838.00€ e përbëjnë: Granti i Përgjithshëm me shumën prej: 5,916,282.00€ që në përqindje është 35.32% e vlerës totale, Granti i Arsimit me shumën

prej: 5,530,790.00€ ose 33% e vlerës totale, Granti i Shëndetësisë me shumën prej: 1,841,091.00€ ose 11% e vlerës totale dhe në fund të Hyrat Vetjake me shumën prej: 3,459,675.00€ ose 20.65% e vlerës totale. Të hyrat vetjake janë të paraqitura në mënyrë të detajuar në tabelën Nr. 2, të cilat e arrijnë këtë vlerë totale. Kur e bëjmë krahasimin e buxhetin me vitin 2024 d.m.th me vitin aktual buxhetor: Granti i Përgjithshëm është rritur për shumën prej: 436,217.00€ ose 7.96%, pastaj Granti i Arsimit me shumën prej: 252,167.00€ ose 4.77%, pastaj Granti i Shëndetësisë me shumën prej: 28,886.00€ ose 1.60% dhe në fund kemi një ulje të hyrave vetjake në shumë prej: minus 254,932.00€ më pak ose minus 6.86%. Pra buxheti i vitit 2025 në krahasim me vitin 2024, është rritur në shumën prej: 462,338.00€ ose 3% më shumë. Ky buxhet është shpërndar në pesë kategoritë ekonomike, ku e keni të paraqitur në tabelën Nr. 3, pra po fillojmë me radhë: Numri i punëtorëve është paraparë 1341, nga 991 të këtij viti - kërkesat janë bërë për 350 punëtorë të rinjë, ku ky numër është shpërndarë si vijon: 40 në Administratën Komunale, 84 në Shëndetësi, 2 më shumë në administratën e shëndetësisë, 77 në Shëndetësi Primare dhe 5 në Shërbimet Sociale, 226 në Arsim prej tyre 2 në Administratën e Arsimit, 21 Arsimi Parashkollor, 195 Arsimi Fillor dhe 8 në atë të Mesëm. Buxheti total për kategorinë ekonomike të Pagave dhe Mëditje është në shumën e mjeteve financiare prej: 8,192,195.00€, me një rritje prej: 262,601.00€ krahasuar me buxhetin e vitit 2024, për kategorinë ekonomike të Mallra dhe Shërbime është shuma prej: 2,125,968.00€, është zvogëluar për: 34,357.00€, për kategorinë ekonomike të Shpenzimeve Komunale është shuma prej: 350,000.00€ është e njëjtë me vitin aktual, për kategorinë ekonomike të Subvencioneve dhe Transfereve është shuma prej: 1,298,675.00€, me një rritje prej: 174,068.00€ krahasuar me buxhetin e vitit aktual dhe në fund për kategorinë ekonomike të Shpenzimeve Kapitale është shuma e mjeteve financiare për investime publike prej: 4,781,000.00€, me një rritje prej: 140,026.00€. Në tabelat Nr. 4 dhe 5 ku është bërë shpërndarja e buxhetit për vitet 2026-2027, nuk do të ndalemi sepse janë vetëm projeksione dhe sigurisht se do të ketë ndryshime, në të gjitha kategoritë për shkak të rritjes së popullatës. Në tabelën Nr. 6 i keni të paraqitura Investimet Kapitale, të cilat janë financuar nga Transferet Qeveritare me 2,620,000.00€ dhe 2,161,000.00€ nga të Hyrat Vetjake. Projektet Kapitale nuk po i lexoj një nga një, sepse i keni para jush, por theksojmë që jemi në fazën fillestare, do të jenë edhe tri Dëgjime Buxhetore, dy në muajin korrik me datat 05 e 26 korrik dhe një më 23.08.2024, ku do të mirren kërkesat e qytetarëve, ato do të shqyrtohen me Ekzekutivin e Komunës dhe do të inkorporohen në buxhetin e vitit 2025.

Laureat Gojnovci: Projekt-Korniza Afatmesme Buxhetore Komunale, për vitet 2025-2027, është dokumenti më i rëndësishëm financiarë, ky planifikohen projeksionet buxhetore makro ekonomike si orientim për hartimin e buxhetit të komunës për vitin 2025, i cili ndoshta mund të rritet në kufijtë e tij buxhetorë, që mund të ndryshojnë, nëse bëhet zyrtarizimi i rezultatit të popullsisë. Buxheti komunal është i shpërndarë në kodet e programeve dhe nën programeve, buxheti total është në shumën e mjeteve financiare prej: 16,000,000.00€, ose 3%, ndërsa orientimet dhe projeksionet buxhetore për vitin 2026 është 17,000,000.00€ dhe për vitin 2027 është 18,000,000.00€. Buxheti për projekte kapitale është më i madh për shumën e mjeteve financiare prej 1.2 milion euro, këtu nga granti qeveritarë do të financohet edhe impianti për trajtimin e ujërave të zeza, tek shërbimet publike që përfshinë një shumë në përqindje 16%, e buxhetit total, ku një shumë e mjeteve financiare prej: 260,000.00€ do të jetë nga të hyrat vetjake. Në infrastrukturë shkon 39% e buxhetit, në shëndetësi do të investohen shuma e mjeteve financiare prej: 450,000.00€, në arsim shuma e mjeteve financiare prej: 540,000.00€, ku parashihen të ndërtohen edhe dy çerdhe publike, njëra në

fshatin Miradi e Epërme dhe tjetra në fshatin Sllatinë e Madhe, në fushën e kulturës dhe sportit, parashihet që të renovohet Stadiumi i Futbollit 'Ekrem Grajçevci' në Fushë-Kosovë, ndërtimi i tij që ka filluar këtë vitë të zhvillohet në dy faza gjatë këtij viti dhe në vitin 2025, pra ky buxhet është gjithëpërfshirës, me projekte kapitale publike në secilin vendbanim, gjatë diskutimeve publike ka hapësirë për ndryshime, andaj ne në emër të anëtarëve të Grupit Parlamentarë të Lidhjes Demokratike të Kosovës, propozojmë që 'Projekt-Korniza Afatmesme Buxhetore Komunale për vitet 2025-2027', të aprovohet.

Durim Hajra: Kjo projekt-kornizë për buxhetin e komunës për vitin 2025, që është vitë zgjedhorë dhe projeksionet fillestare për vitet 2026 dhe 2027, këtu vëren dy elemente, që ky buxhet strukturohet dhe orientohet nga Kryetari i Komunës z. Burim Berisha, ku nuk janë projektet kapitale që janë premtuar në fushatën e fundit elektorale, as në vitin e katërt të mandatit zgjedhor, nuk ka ndonjë risi, buxheti është po thuaj se i njëjtë, jo kreativ, ndërsa gjendja në teren kërkon shumë investime publike, që nuk janë të planifikuara me buxhet, as për vitin 2025. Këtu nga Shefi i Grupit Parlamentarë të Lidhjes Demokratike të Kosovës u tha, se buxheti është i bazuar në kërkesat dhe nevojat e paraqitura nga qytetarët e komunës, pse jo kur për asfaltime janë të planifikuara shuma e mjeteve financiare prej: 670,000.00€, ku pritet të asfaltohen prapë rrugët e njëjta, disa prej tyre edhe në prona private dhe oborre të qytetarëve për mirëmbajtjen e votës elektorale. Buxheti me rritje nuk pritet të vjen deri në vitin 2026, por atëherë komuna jonë nuk do të qeveriset më nga Kryetari z. Burim Berisha, i cili ka realizuar vetëm dy nga projektet e premtuara në fushatën zgjedhore. Është premtuar me vite rregullimi i Sheshit në lagjen 'Dardania', i cili nuk është realizuar asnjëherë, janë ndarë mjete financiare për këtë punë, por projekti nuk ka filluar, këtë vitë aty janë mbjellur pemë dekorative, pastaj premtimi tjetër, projekti për ndërtimin e Stadiumit në fshatin Lismir për sportistët e komunës tonë nuk është realizuar, hapësira e tregut në lagjen e Bresjes është zënë nga operatorët privat. Këtu deri tani janë shtatë projekte elektorale, janë mashtrime elektorale, këtu hyn: ujësjellësi i ri Sllatinë e Madhe / Bardh i Madh / Graboc i Poshtëm, por gjendja është mirë sepse projektin e ujësjellësit e sjelli dhe po e realizon vetë Qeveria e Kosovës nëpërmjet Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal. Në projeksionet buxhetore për vitet 2026 dhe 2027 parashihet prapë blerja e automjeteve - skiperit në shumën e mjeteve financiare prej: 90,000.00€, renovimi i objekteve të vjetra banesore në lagjen e Bresjes, por nuk parashihet asnjë investim publikë në zonën e Ish/Kolonisë, shtruarja e rrugëve bujqësore me zhavor në fshatra, projekti për nënkalimin është i dështuar, sepse nuk janë konsultuar ekspertët e fushës, sepse kjo zonë është në nivelin e lumit, në projeksionet e hershme buxhetore po ashtu është e planifikuar edhe ndërtimi i Shtëpisë për personat e moshuar, mungon Qendra Multifunktionale që është premtuar por nuk është realizuar nga ky Ekzekutiv i Komunës, pra është mashtrim, por për Shefin e Grupit Parlamentarë të partisë në pushtet në buxhet janë të përfshira kërkesat e qytetarëve.

Migjen Kolshi: Këtu rregullat dihen partia që qeveris me komunën, e ka marrë pushtetin, e bënë planifikimin e buxhetit, por unë nuk mund të përkrah buxhetin komunal në fund, nëse ai ka mangësi që ne duhet t'i adresojmë, andaj unë kërkoi që në buxhetin e komunës për vitin 2025, të hyn projekti për rregullimin e rrjetit të ujësjellësit në fshatin Harilaç dhe për këtë projekt kapital të ndahet shuma e mjeteve financiare prej: 200,000.00€. Ju po e shihni se buxheti i komunës është koncentruar në fshatin Bradh i Madh, me asfaltime të rrugëve është dy qind mijë euro, ndërsa për fshatin Harilaç vetëm pesëmbëdhjetë mijë euro, ndërsa në disa fshatra tjera vetëm nga dhjetë mijë

euro, sepse Lëvizja Vetëvendosje si pushtet qendror është duke e rregulluar rrjetin e ujës-jellës në këtë fshat, që ju nuk e keni bërë, këto punë si nga pushteti qendror ashtu edhe nga pushteti lokal bëhen për vota në këtë fshat. Buxheti i propozuar nëpër fshatra nuk është i balancuar, parashihet ndërtimi i çerdheve të fëmijeve në fshatrat: Miradi e Epërme dhe Sllatinë e Madhe, ndërsa nuk parashihet ndonjë investim i rëndësishëm publik në fshatrat: Harilaç dhe Graboc i Poshtëm. Në qytet parashihet shuma e mjeteve financiare prej: 350,000.00€ për rregullimin e rrugës 'Hajrullah Zymi' në Fushë-Kosovë, që është një ndër rrugët kryesore e dëmtuar shumë, pastaj tani janë duke u mbjellur pemë dekorative në lagjen e Dardanisë nëpër disa rrugë, por duhet të mendohet edhe për pastrimin e rrugëve. Një projekt i mirë për të ardhmen dhe zhvillimin e aktiviteteve të futbollistëve dhe rinisë së komunës tonë, është rindërtimi i Stadiumit të Futbollit 'Ekrem Graçevci' në Fushë-Kosovë, që ka filluar këtë vitë. Unë e votoi këtë 'Projekt-Kornizë Afatmesme Buxhetore Komunale për vitet 2025-2027', nëse në buxhet ndahet shuma e mjeteve financiare prej: 400,000.00€, për rregullimin e ujit të pishëm për banorët e fshatit Harilaç, unë dal nga qëndrimi i Grupit Parlamentarë të Partisë Demokratike të Kosovës dhe e votoi buxhetin.

Hasan Ismajli: Këtu u cekë nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës problemi që kanë banorët të banesat e Kompleksit 'Eliza', ku lejet e ndërtimit janë dhënë jashtëligjshëm, atje sipas Hartës Zonale të Komunës, ka qenë e paraparë të jetë ndërtimi i ulët, por janë lëshuar leje për ndërtim të lartë, por neve këtu nuk na u dhanë përgjigje nga ana e Ekzekutivit të Komunës, u injorua, kjo punë është e pakuptueshme, ne nuk morëm një përgjigje, as për dëmet në bujqësi që janë shkaktuar nga shiu dhe breshëri i fundit, ku shumë fermerëve përveç dëmeve të kulturave të grurit dhe misrit, u janë dëmtuar edhe bahçet. Këtu para neve 'Projekt-Kornizë Afatmesme Buxhetore Komunale për vitet 2025-2027', e paraqiti znj. Shqipe Islami, por në projeksionet buxhetore nuk është paraparë nga Ekzekutivi i Komunës asgjë për varrezat e qytetit në Fushë-Kosovës, ku janë vetëm edhe 600 metra katëror, një hapësirë e mbetur prej vetëm 50 metra gjatësi dhe 12 metra gjerësi, ku mund të varrosen vetëm edhe 200 të vdekur, nuk parashihet asgjë në buxhet. Për ndërtimin e Shtëpisë së të moshurave, është paraparë një shumë e mjeteve financiare prej: 100,000.00€, por ku do të ndërtohet ky objekt, kur prona komunale është avulluar, te 'Parku i Pishave' në fshatin Sllatinë e Vogël është një lokacion i mirë, por atje prona me marrëveshje me Ministrinë e Kulturës Rinisë dhe Sportit, është dhënë për kopshtin botanik. Me punën e dëmeve në bujqësi mirret Drejtoria e Shërbimeve Publike e Mjedisit, e jo Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, anëtarët e Komisionit për vlerësimin e dëmeve në bujqësi, janë shumica të shërbimeve publike, kjo punë nuk bëhet kështu, duhet të jeni më aktiv në këtë drejtim, sepse do të dëmtohen fermerët tonë. Unë nuk mund ta votoi këtë buxhet, nëse në të nuk kthehet 'Kodi për ndarjen e mjeteve financiare për zgjerimin e pronës së varrezave në qytetin e Fushë-Kosovës'.

Shpend Bardiqi: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Ky është një buxhet i përgatitur pa ide të reja, pa ndonjë kreativitet, me njerëz të vjetër, me ide e projekte të njëjta dhe të vjetra, këtu duhet të ndryshohet qasja ndaj punëve publike, por kjo nuk mund të bëhet nga ky pushtet, tani kjo punë shihet më së mirë nga gjendja e Sallës së Kuvendit të Komunës, ku për tre vite nuk ka asnjë ndryshim, andaj nuk kemi çka të presim më shumë për projekte kapitale në interesin e qytetarëve në teren. Për ekranin e qytetit si projekt i inovacionit, parashihet një shumë e mjeteve financiare prej: 150,000.00€, por ju së pari nuk e keni realizuar ende as investimin e paraparë në shumën e mjeteve financiare prej: 40,000.00€ për këtë çështje gjatë këtij vite, pastaj për ndërtimin e urave në vitin 2025, është paraparë shuma e mjeteve financiare prej: 40,000.00€, kjo shumë është

qesharake, nuk punohet në pastrimin e lumenjëve, ne i kemi dy lumenjë të mëdhenjë Drenicën dhe Sitnicën, shuma prej 250,000.00€, këtu nuk mjafton, vendosja e ndriçimit publik në shumë prej: 50,000.00€, shënjëzimi i rrugëve vetëm një shumë prej: 30,000.00€, asfaltime nga dhjetë mijë euro, kënde të lojërave nga dhjetë mijë euro. Kërkesa ime është që të asfaltohet rruga 'UÇK Bardhi', së paku këto punë duhet t'i shënoni drejtë ashtu si duhet, e jo me gabime, cilat rrugë tjera do të asfaltohen në lagjet e komuniteteve 028 dhe 029, cilat do të jenë projektet kapitale në rrugën 'Dardania', ku së pari duhet të largohen terasat nga prona e uzurpuar, por ju këtë punë nuk mund ta bëni, andaj pemët dekorative, i keni mbjellur në trotuare.

Habib Mekolli: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Ju po e shihni shumicën e projekteve kapitale, ku dominojnë asfaltimet, por njerëzit së pari duhet ta kenë ujin e pishëm në shtëpitë e tyre, andaj kërkesa për rregullimin e rrjetit të ujësjellësit në fshatrat: Harilaç dhe Graboc i Poshtëm është një kërkesë e arsyeshme, për këtë punë janë të ndara nga granti qeveritarë një shumë e mjeteve financiare prej: 260,000.00€, ndërsa nga të hyrat vetjake kodi është zero. Nga Drejtoria e Shërbimeve Publike e Mjedisit jemi lodhur kohëve të fundit me përshkrimin dhe lëvdatat për punë publike në teren, por brenda këtu në objektin e komunës tauletet janë në gjendje shumë të keqe, është e vërtetë se disa punë kryehen në teren nga punëtorët fizik, sikur është edhe kositja e barit në rrugën 'Nënë Tereza' në Fushë-Kosovë, por kjo është një shërbim që qytetarëve duhet t'iu kthehet, sepse ata paguajnë taksat komunale, ku të hyrat kryesore të buxhetit komunal janë nga lejet e ndërtimit dhe tatimi në pronë, në Shërbimin e tatimit në pronë, ka probleme me numrin e punëtorëve, aty ka disa punëtorë të Projektit të Karitasit, ku me punën e tyre nuk mund të respektohet kërkesa për verifikimin e 20% të tatim paguesve, të cilët nuk kanë as mjete të punës, matjet në teren i bëjnë me metër pantike, nuk kanë ndonjë mjetë laserik për matje. Edhe në vitin 2025 parashihet buxhet për rrugën 'Hajrullah Zymi' dhe rrugën 'Hamdi Grajçevci' në Fushë-Kosovë, por këto punë nuk po realizohen asnjëherë në teren. Në rrugët e brendshme të qytetit mungon shtegu për biçikleta, ndërsa shtegu për biçikleta në rrugën kryesore bllokohet nga këmbësorët, sepse trotuaret janë të zënë nga automjetet e parkuara në zona të ndryshme, pastaj problemi i uzurpimeve me terasa në rrugën 'Dardania', por ne shpresojmë se gjatë dëgjimeve buxhetore, do të mirren parashys kërkesat e qytetarëve për investime publike në disa rrugë të qytetit tonë, andaj për këtë punë ne do të angazhohemi gjatë organizimit të dëgjimeve buxhetore nga komuna, të cilat deri tani mbahen vetëm në objektin e komunës në orarin e punës dhe asnjëherë në teren.

Vlonjat Hasani: Përshëndetje për të gjithë, sa i përket Kornizës Afatmesme Buxhetore Komunale për vitin 2025-2027, shumë u tha dhe shumë pak më lanë hapësirë me i dhënë vërejtjet, sugjerimet apo kritikën, mirëpo edhe kjo që më ka mbetë e kam përmendur edhe në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa dhe aty ka qenë prezent edhe hartuesi real i këtij buxheti, unë kam bërë një vlerësim mes viteve 2024, 2025, 2026, 2027 dhe është shumë e çuditshme, sepse pas presjes dhjetore të gjithë numrat janë të njëjtë. Të nderuar materialin e keni përpara dhe mundeni me vërtetuar këtë që po e them unë, sepse secila ndarje buxhetore është e njëjtë këty ndryshon vetëm presja dhjetore. Administrata dhe Personeli është 90,000.00€ dhe vetëm ju ka shtuar edhe një shumë tjetër, ku edhe centat janë të njëjtë për vite. Kjo është shumë e çuditshme, mirëpo profesionistat e kanë përpiluar këtë të cilët po na binë përpara dhe po kërkojnë me votuar, me të vërtetë qesharake dhe e dhimbshme. Ne kemi thënë edhe në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa, se nuk e kemi parashikuar buxhetin për rregulloret të cilat janë miratuar në Kuvendin e Komunës dhe që priten mu votuar në Kuvend dhe të cilat kanë implikime buxhetore dhe ju si

keni paraparë, ky është serioziteti i punës së juaj për ndarjen buxhetore. Nëse shkojmë gradualisht, këtu kemi ndërtimin e urave dhe lumenjeve, ne e dimë problemin me të cilin ballafaqohen banorët e fshatrave Miradi e Poshtme dhe Miradi e Epërme, problemi me lumin ‘Graçanka’ dhe këtu nuk është paraparë edhe pse kjo shumë prej: 40,000.00€ është qesharake, sepse asnjë urë nuk mundet me u përfunduar me këtë shumë, ashtu siç duhet, ky planifikim e shpërfaqë qartë seriozitetin e juaj ndaj qytetarit, të cilët do të informohen për këtë, pastaj tek kanalizimi dhe ujësjellësi mirë shumë që kanë hyr fshati Harilaç dhe Graboc i Poshtëm, sepse prej fillimi të këtij mandatit ju e keni të identifikuar rrugën ‘Lumi’ të cilën e kemi përmend në secilën mbledhje dhe kjo nuk është inkorporuar këtu, nuk e di se çka keni kundër kësaj rruge dhe atyre banorëve, ju keni ndarë buxhet prej: 200,000.00€ për kanalizim për Harilaç dhe Graboc të Poshtëm dhe për këtë rrugë nuk keni planifikuar asgjë, me të vërtetë është e çuditshme. Mbjelljen e pemëve dekorative i përmendem te gjithë, mirëpo nëse ka mundësi dikush prej atyre që kanë vendos mi mbjell këto pemë ku është dallimi, mes këtyre pemëve që janë mbjellë për momentin dhe po thahen e çdo ditë po i shohim që ajo kompani po i bartë këto të thata dhe po i dërgon atje tek vendi i vetë. Ku është dallimi mes këtyre pemëve dhe pallmave të Kaçanikut. Nëse ka mundësi dikush të na bëjë dallimin. Asfaltimet në Vragoli për katër rrugë janë ndarë 10,000.00€, nuk e di çfarë asfalti ka mu bërë në këto rrugë me këtë shumë e çuditshme. Miradi të Epërme po ashtu janë tri rrugë me 10,000.00€, ku këtu ka nevojë edhe për shumë rrugë tjera të cilat nuk janë këtu të planifikuara fare, po ashtu në Miradi të Poshtme janë gjashtë rrugë me 10,000.00€ edhe kjo shumë e çuditshme. Renovimi i fushave të futbollit me bari sintetik, tek këto shkollat të cilat janë parashikuar është edhe në ‘Vëllezërit Frashëri’ në Vragoli, por ju e dini shumë mirë që edhe në Miradi të Epërme, ka shumë nevojë me u rregulluar fusha e futbollit me bari sintetik, sepse aty mbahen disa aktivitete sportive, e te cilat duhet pa tjetër të shkojnë nëpër fusha private, kur kjo ka mundësi me u rregulluar. Blerja e inventarit në Bardh të Madhë në shkollën ‘Zenel Salihu’ në shumën 30,000.00€ është e çuditshme se vlerat janë shumë pakë të ndara e nevojat për këto shkolla janë shumë të mëdha. Ndërtimi i çerdhës në Miradi të Epërme që është e parashikuar, ta kemi parasysh që ky ka qenë edhe propozim i Lëvizjes Vetëvendosje dhe shumë mirë që është inkorporuar këtu, mirëpo mbetet ta shohim si po implementohet dhe si po bëhet kjo çerdhe. Kemi edhe renovimin e stadiumit të futbollit në Miradi të Epërme në vlerë prej: 55,000.00€, ky është premtim elektorial i Burim Berishës i grupit tij në fushat ka qenë para tri viteve, ku kanë thënë se do bëhet renovimi i fushës së futbollit, zgjerimi dhe renovimi në shkollën e Miradisë së Epërme dhe banorët duhet të informohen me këto mashtrime elektoriale, sepse nuk jemi duke e parë asnjë nga këto premtime.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Unë tani këtu do të flas në emër të Partisë së Drejtësisë, ku si një partner i kualicionit nuk jam konsultuar fare për buxhetin e vitit 2025, këtu u theksua se buxheti për vitin 2025 dhe projeksionet fillestare buxhetore për vitet 2026 dhe 2027, janë mbështetur në kërkesat e qytetarëve, që vijnë nëpër Drejtori të Komunës, tani dua të them se për një buxhet të komunës që është në shumën e mjeteve financiare prej: 16,000,000.00€, zëri im nuk është dëgjuar, pavarësisht pozicionit politikë dhe pozitës që unë e mbajë në Kuvendin e Komunës, kjo punë nuk është fare në rregull, kjo qasje e trajtimit të partnerëve politikë duhet të ndryshon. Unë nuk do ta votoi këtë buxhet nëse në projekte kapitale për vitin 2025, nuk hyn asfaltimi i rrugës ‘Pajazit Islami’ në Fushë-Kosovë, ku aty përveç asfaltimit duhet të rregullohet edhe rrjeti i kanalizimit, sepse aty tani kemi shumë objekte banesore, do ta kemi edhe objektin e ri shkollorë. Po ashtu kërkesë e jona është që të sigurohet prona për varreza në Fushë-Kosovë, që u cekë edhe nga kolegu ynë z. Hasan Ismajli, kjo çështje duhet të hyn në buxhet, projekti për Sheshin në rrugën ‘Dardania’, që nuk është realizuar, është bartur nga viti në vitë, tani nuk parashihet fare në buxhet,

sepse kjo punë duhet të jetë me serioze, të mirren inxhinierë dhe arkitekt për strukturimin e tij, ky buxhet tani do të kalon në fazën e diskutimit publik, do të kthehet pas dy muajve në shqyrtim në Kuvendin e Komunës, ne do të shohim nëse do të mirren parasysh kërkesat tona për investime publike, që janë projekte të rëndësishme, për mirëqenien e qytetarëve dhe përmirësimin e kushteve të jetesës në zonën urbane të qytetit. Unë buxhetin e kaluar e kam votuar, pas vendosjes së 'Kodit të projektit për zgjerimin e hapësirës së varrezave në Fushë-Kosovë dhe fshatin Miradi e Epërme', ky kod i projektit kapital tani nuk figuron fare në buxhetin e komunës për vitin 2025, është hequr, andaj unë jam kundër aprovimit të këtij buxheti në këtë formë.

Hasan Ismajli: Unë e kam patur një kërkesë të paraqitur edhe më herët për hapjen e kodit për planifikimin e mjeteve financiare për zgjerimin e varrezave në Fushë-Kosovë, kjo kërkesë më herët është ngritur edhe nga kolegu ynë z. Bashkim Krasniqi, është përsërituar disa herë edhe nga unë dhe Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, mirëpo tani ky kod është hequr nga buxheti i komunës. Në Fushë-Kosovës tani ka shumë pak hapësirë në varreza, ka mbetur një sipërfaqe 50 metra gjatësi dhe 12 metra gjerësi, ku mund të jenë edhe dy qind vend varrime, andaj ju ftoj që ta keni parasysh këtë fakt dhe të ndani buxhet për blerjen e pronës për varreza në qytetin e Fushë-Kosovës. Unë e kam edhe një çështje ku kërkoi që të ndahet një buxhet për rregullimin e rrjetit të kanalizimit nga rrethi deri te objektet banesore të ACL-së, ku kanalizimi është ndërtuar shumë herët dhe uji ju hyn një qind e pesë dhjetë familjeve në bodrume. Deri sa unë nuk e shoh që në buxhet hyn kërkesat e mia që janë të arsyeshme, nuk mund ta jap votën e tyre për aprovimin e 'Projekt-Kornizës Afatmesme Buxhetore Komunale për vitet 2025 - 2027'.

Pas sqarimeve Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, e qiti në votim për aprovim 'Propozimin për Projekt-Kornizës Afatmesme Buxhetore Komunale për vitet 2025 - 2027'.

U votua me: katërmëdhjetë vota 'për', një votë 'kundër' dhe asnjë abstenim, gjithsej pesëmbëdhjetë pjesëmarrës në votim, nga anëtarët e pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Kuvendi i Komunës me shumicë të votave të anëtarëve pjesëmarrës në votim e aprovoi 'Propozimin për Projekt-Kornizës Afatmesme Buxhetore Komunale për vitet 2025 - 2027' dhe mori:

V E N D I M

1. Për aprovimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore Komunale për vitet 2025 - 2027, në Komunën e Fushë-Kosovës, me kufijtë e caktuar buxhetor si vijon:
 - 1.1 Për vitin 2025 buxheti i komunës është në shumë prej: 16,747,838.00€;
 - 1.2 Për vitin 2026 buxheti i komunës është në shumë prej: 17,592.179.00€ dhe
 - 1.3 Për vitin 2027 buxheti i komunës është në shumë prej: 18,456,253.00€.

Pika e katërt (4) - Të ndryshme.


Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: E kemi pikën 'Të ndryshme', ftoi anëtarët e Kuvendit të Komunës, që ta marrin fjalën nëse e kanë ndonjë çështje për diskutim.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës falënderoi të pranishmit për pjesëmarrje në mbledhje.

Mbledhja përfundoi në orën 12:20 minuta.

Procesmbajtës

Hasan Gjyrevci



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Ali Ismaili

